



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 24/2009

Më 23. 09. 2009, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit, Ethem Çeku, Sala Berisha – Shala, Fatmir Rexhepi, Kaqusha Jashari, Safete Hadërgjonaj, Berim Ramosaj dhe Zef Morina.

Munguan: Slobodan Petroviq dhe Múfera Şinik.

Pjesëmarrës të tjerë: Siv-Katrine Leirtroe – ICO, Haxhi Gashi – USAID, Lumnije Murati – ZPK, Rrezarta Ahmeti – KDI dhe Ibrahim Krasniqi – konsulent i Komisionit.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.07.2009;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 03/71 të datës 03. 07. 2009, lidhur me propozimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave të Kosovës;
4. Të ndryshme.

I. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejte.

II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21. 07. 2009

Procesverbali i mbledhjes së datës 21. 07. 2009 u miratua pa vërejtje.

III. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 03/71, të datës 03. 07. 2009, lidhur me propozimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave të Kosovës

Kryetarja – I njoftoi anëtarët e Komisionit për vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 03/71, të datës 03. 07. 2009, lidhur me propozimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave të Kosovës, të cilët janë: Halit Gara, Gëzim Qerimi dhe Ilmi Ahmeti. Mirëpo theksoj se ky propozim është në kundërshtim me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës, respektivisht me nenin 7, ku cekët qartë se cilat kushte duhet të plotësojnë kandidatet për anëtarë të Bordit të Hekurudhave. Ligji thotë qartë se: Neni 7.2 a) anëtarë të Bordit duhet të kenë diplomë universitare apo kualifikim përkatës profesional ose teknik; b) të kenë sqepaku 3 vjet përvojë në sektorin hekurudhor në Kosovë apo në fusha tjera përkatëse; c) njohuri për kërkesat mbi sigurinë për hekurudhat; dhe Neni 7.3 thotë a) që asnjë person nuk mund të emërohet behët apo të mbetet anëtar i Bordit nëse është: nëpunës ose zyrtar i lartë i Qeverisë ose ndonjë organi tjetër publik të Kosovës dhe b) të mos jetë aktivisht i përfshirë në parti politike, andaj të propozuarit janë nuk i plotësojnë këto kushte të parapara me Ligj dhe njiherit hapi debatin lidhur me këtë çështje.

Fatmir Rexhepi – Theksoi se pajtohet me listën e propozuar, mirëpo kërkoi të sqarohet komunikimi Kryesi – Komision, sepse Komisioni vetëm mund të rekomandojë me sqarime, që Kryesia të vendosë a do ta procedojë për seancë apo jo.

Ethem Çeku – Theksoi se duhet të jemi vigjilentë në lidhje me rastet e tilla për anëtarë të Bordit që të mos kritikohet Komisioni, sikurse në seancën e kaluar. Shtoi se ne duhet t'ia kthejmë një shkresë Kryesisë, sidoqoftë, sepse i është drejtuar Komisionit, ndërkaq si do të vendoset është çështje tjetër.

Kaqusha Jashari – Në fillim pyeti se a e parashikon Ligji të jenë pesë (5) apo tre (3) anëtarë të Bordit? Ajo shprehu shqetësimin për kandidatët e propozuar për shkak të përvojës së tyre, përkatësisht për kandidatin e dytë, Gëzim Qerimi, që po ashtu është aktivist politik. Kjo është në kundërshtim me ligjin. Ndërkaq për kandidatin e parë dhe për të tretin nuk kishte vërejtje. Në fund tha se ka rezerva për këtë propozim.

Berim Ramosaj – Në parim nuk e kundërshtoi propozimvendimin, por kërkoi të informohet më tepër për dispozitat ligjore. Kërkoi nga administrata ta marrë një këshillë ligjore se: a ka kushte ligjore Komisioni ta shqyrtojë një propozimvendim të tillë dhe të propozuarit për anëtarë të Bordit të Hekurudhave a i plotësojnë kushtet në bazë të ligjit?

Zef Morina – Shtoi se në bazë të ligjit Komisioni nuk ka të drejtë ta shqyrtojë këtë propozimvendim të Qeverisë, sepse ne mund të flasim në seancë plenare veç e veç si deputetë dhe t'i paraqesim pikëpamjet. Në qoftë se Komisioni nuk e përkrah, çka do të ndodhë, pyeti Morina?

Safete Hadergjonaj – U pajtua me Morinën, që Komisionin nuk e detyron ligji ta marrë një vendim lidhur me propozimvendimin e Qeverisë, mirëpo shtoi se Komisioni mund të shqyrtojë një propozimvendim të tillë dhe pastaj mbetet çështje e Kryesisë se kur dhe si do ta procedojë për seancë plenare. Në fund shfaq shqetësimin për përgatitjen profesionale të kandidatëve të propozuar.

Sala Berisha Shala – Kërkoi që Komisioni të mos detyrohet t'i shqyrtojë çështjet për të cilat nuk e detyron ligji. Ndërkaq, sa u përket të propozuarve theksoi se nuk ka informacione të tjera, përveç të propozuarit të tretë, Ilmi Ahmetit, i cili ishte deputet dhe njëherit anëtar i Komisionit për ETIETT, në mandatin e kaluar.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Përfundim

- I. Njësia Mbështetëse e Komisionit për mbledhjen e radhës ta përgatitë një raport gjithëpërfshirës, me të dhëna që kanë ofruar kandidatët e propozuar nga Qeveria e Kosovës, si dhe për kushtet e përcaktuara me ligj që kërkohen për anëtarë të Bordit të Hekurudhave të Kosovës.

IV. Të ndryshme

a) Formimi i grupeve të punës për projektligjet e miratuara në parim

Kryetarja – Kërkoi nga anëtarët e Komisionit të kontribuojnë secili në një grup pune, në mënyrë që secili grup parlamentar të jetë i përfaqësuar në një prej shqyrtimeve të projektligjeve.

Pas debatit Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- I. Grupi i punës për Projektligjin për miniera dhe minerale është i përbërë: Sala Berisha – Shala, Ethem Çeku dhe Myzejene Selmani;
- II. Grupi i punës i Projektligjit për caktimin e të drejtave dhe të mbrojtjes së topografisë së qarqeve të integruara, përbëhet nga: Fatmir Rexhepi, Kaqusha Jashari dhe Myzejene Selmani;
- III. Grupi i punës për Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e krimit dhe kibernetikë, ka këtë përbërje: Zef Morina, Berim Ramosaj dhe Myzejene Selmani;
- IV. Grupi i punës për Projektligjin për turizmin dhe për shërbimet turistike, ka këtë përbërje: Safete Hadergjonaj, Berim Ramosaj dhe Myzejene Selmani;

Ethem Çeku – Propozoi të organizohet një shqyrtim publik për Projektligjin për miniera dhe minerale.

Propozimi u pranua nga të pranishmit, kurse data dhe pjesëmarrësit do të caktohen në

mbledhjen e radhës.

b) Çështje vijuese

Në mbledhjen e radhës do të shqyrtohet situata aktuale në kompleksin e minierave të Trepçës. Për këtë mbledhje kërkohet material përkatës nga MEM-i, si dhe ftohet ministresha e MEM-it për të ofruar informacione lidhur me temën.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani